



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA**

VENDIM

Nr. 6, date 23.02.2015

**PËR DËNIMIN ADMINISTRATIV TË SHOQËRISË 'UJËSJELLËS KANALIZIME
VLORË SH.A.'**

Në zbatim të nenit 14, gërma "h", nenit 15 dhe nenit 32/1, pika 1, gërma "ç", të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 për "Kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ligjit 10279, date 20.05.2010 për "Kundërvajtjet administrative" dhe Rregulloren e ERRU, për "Procedurat e konstatimi dhe shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative dhe marrjen e vendimit për dënimin e kundërvajtjeve administrative në sektorin e furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", miratuar me vendim të KKRR, nr. 01, datë 06.01.2012, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI

1. Shoqëria "Ujësjiellës Kanalizime Vlorë" sh.a. për ushtrim të veprimtarive të grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik dhe largimin e trajtimin e ujërave të ndotura pa licencën përkatëse, dënohet me gjobë në shumën 300 000 leke.
2. Ngarkohen Sektori Juridik dhe Marrëdhëniet me Publikun dhe Sektori Administratës, Financës dhe Burimeve Njerëzore për ndjekjen e procedurave në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Avni Dervishi**